



SHKOLLA E MESME E LARTË "NAIM FRASHËRI" SHËTIVE SHKOLLA E MESME PROFESIONALE-SHËTIVE

Adresa: Rruga "Isa Boletini", nr. 92, 72000 Shtime
Tel. 0290/390-564

Nr. i Protokollit: 417/6

Datë: 12. 3. 2019

Duke u bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2016 dhe të rikonfirmuar më 11.03.2019

SHKOLLA E MESME E LARTË "NAIM FRASHËRI" dhe SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
NË SHËTIVE shpall:

OFERTË PËR EKSURSION

Shkolla e Mesme e Lartë "Naim Frashëri" në Shtime, bënë organizimin e Ekskursionit të Maturantëve për në Shqipëri prej datës 1. 4. 2019 deri më 5. 4. 2019 sipas Udhëzimit Administrativ për Aktivitetet Jashtëshkollore, nr. 02/2016 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Ekskursioni gjatë qëndrimit pesëditor (5) në Shqipëri do të bëhet sipas relacioneve në qytetet:

Itinerari i paraparë për realizim është si vijon:

- Më 1 Prill 2019,
 - Ora 7:00 nga Shtimja bëhet nisja për Durrës.
 - Vendosja në Hotel nga ora 12:00-13:00. Sistemimi nëpër dhoma gjumi. Dhomat të pajisura me jo më shumë se tre shtretër. Secila dhomë të ketë banjon e vetë me ujë të ngrohtë gjatë gjithë kohës. Mbulesa të pastërta dhe të mjaftueshme.
 - Dreka:200gr mish viçi (gullash), sallatë e përzier dhe nga një pije 350ml, si dhe ujë të pagazuar pakufi. Sasia e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik.
 - Më 1 prill 2019, vizitë qytetit të vjetër të Durrësit dhe amfiteatrit antik; Pagesa për hyrjen e nxënësve në amfiteatër bëhet nga kompania kontraktuese.
 - Darka: 19:00-20:30. File pule (200gr mish i bardhë pule, sallatë e përzier, nga një pije 350ml, si dhe ujë të gazuar pakufi.
 - Muzikë: 21:00-00:00. Muzikë live ose DJ sipas dëshirës së nxënësve. Mbrëmja mbaron në ora 23:00.
- Më 2 Prill 2019,
 - Mëngjesi në ora 07:00-08:30. (Omlet me proshutë ose sallam pule, djathë për nxënës, Mermelatë të llojeve të ndryshme. Nga një pije të ngrohtë (çaj i llojlojshëm si dhe qumësht). Sasi e mjaftueshme e bukës dhe e pijeve të lartcekura.
 - Vizitë: Nisja në ora 09:00 për në qytetin e Krutës, përkatësisht në Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu"; PAGESA PËR HYRJE BËHEN NGA KOMANIA KONTRAKTUESE.
 - Dreka: 14:00. Dreka:200gr mish pule me oriz me sos kërpudhash; sallatë dhe nga një pije 350ml, si dhe ujë të gazuar pakufi. Sasia e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe klorik.
 - Pasdite e lirë: Aktivitete nga kujdestarët e klasave me klasat e tyre.
 - Darka: 19:00-20:30. Musak (Patate të fërguara me mish) sallatë jeshile, nga një pije 350ml, si dhe ujë të pagazuar pakufi).
 - Muzikë: 21:00-00:00. Muzikë live ose DJ sipas dëshirës së nxënësve. Mbrëmja mbaron në ora 23:00.
- Më 3 prill 2019,
 - Mëngjesi në ora 07:00-08:30. (Vezë të ziera për nxënës, Mermelatë të llojeve të ndryshme. Nga një pije të ngrohtë (çaj i llojlojshëm si dhe qumësht). Sasi e mjaftueshme e bukës dhe e pijeve të lartcekura.
 - Vizitë qytetit të Elbasanit; Nisja në ora 09:00.
 - Dreka në Restorant në ora 15:00. Pica (proshutë ose Tona) dhe nga një pije 350ml, si dhe ujë të gazuar pakufi. Sasia e ushqimit të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik. Secila tavolinë të ketë palloma.
 - Kthimi nga Elbasani në ora 15:00
 - Darka: 19:00-20:30. Mish viçi i fërguar (200 gr), pamfrit me garniturë, sallatë jeshile, nga një pije 350ml, si dhe ujë të gazuar pakufi).

- Muzikë: 21:00-00:00. Muzikë live ose DJ sipas dëshirës së nxënësve. Mbrëmja mbaron në ora 23:00.
- Më 4 Prill 2019,
 - Mëngjesi në ora 07:00-08:30. (vezë të fërguara për nxënës, Mermelatë të llojeve të ndryshme. Nga një pije të ngrohtë (çaj i llojlojshëm si dhe qumësht). Sasi e mjaftueshme e bukës dhe e pijeve të lartcekura.
 - Vizitë në qytetin e Vlorës, përkatësisht në Shtëpinë e Pavarësisë. Nisja në ora 09:00. Pagesa për hyrje në Shtëpinë e Pavarësisë bëhet nga kompania kontaktuese.
 - Dreka në Restorant: Fruta deti me garniturë, peshk 500 gr., dhe nga një pije 350ml, si dhe ujë të gazuar pakufi. Sasia e ushqimit të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik. Secila tavolinë të ketë palloma.
 - Kthimi nga Vlora në ora 15:00
 - Darka: 19:00-20:30. Pleskavicë ose qebapa 10 copë, pamfrit me garniturë, sallatë e përzier, nga një pije 350ml, si dhe ujë të gazuar pakufi).
 - Muzikë: 21:00-00:00. Muzikë live ose DJ sipas dëshirës së nxënësve. Mbrëmja mbaron në ora 23:00.
- Më 5 Prill 2019,
 - Mëngjesi në ora 07:00-08:30. (vezë të fërguara për nxënës, Mermelatë të llojeve të ndryshme. Nga një pije të ngrohtë (çaj i llojlojshëm si dhe qumësht). Sasi e mjaftueshme e bukës dhe e pijeve të lartcekura.
 - Vizitë kryeqytetit shqiptar – Tiranës. Nisja në ora 09:00.
 - Kthimi për në Kosovë në ora 14:00.

Bartja e nxënësve (afërsisht 450) bëhet me autobusë nga agjenci turistike sipas relacioneve të lartpërmendura, ndërsa akomodimi dhe qëndrimi bëhet në hotel (Durrës). Akomodimi gjatë qëndrimit përfshin: fjetjen, sigurinë fizike, Sigurinë shëndetësore, ushqimin cilësor dhe klalorik si dhe shërbimin 24 orësh mjekësor.

Ndërkohë, Agjencioni duhet t'i përmbahet të gjitha obligimeve që dalin nga UA 02/2016.

Hoteli duhet të jetë i përshtatshëm. Me jo shumë kate. Nëse ka më shumë se tri kate të posedojë ashensor. Stafit duhet të sigurojë pastërti të ambientit ku rrijnë dhe argëtohen nxënësit. Hoteli duhet të sigurojë po ashtu çmime të njëjta të produkteve të tjera pos atyre që janë në kontratë me të njëjta çmime që janë edhe jashtë hotelit.

Në këtë ofertë mund të konkurrojnë të gjitha agjencitë, të cilat i plotësojnë këto parakushte:

- Të kenë licencën sipas Ligjit mbi Transportin,
- Të kenë bërë dëshmi mbi kontrollin teknik sipas procedurave ligjore dhe teknike,
- Të kenë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevoja të shkollës,
- Autobusët të jenë komfor dhe me kondicioner,
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve,
- Agjencioni duhet t'i ketë fotokopje librezat e autobusëve,
- Të përkrahë nxënësit me shërbime mjekësore si dhe dëshminë e certifikatës së punës së mjekut,
- Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve,
- Në bashkëpunim me hotelin e mundshëm, nxënësve dhe personelit përcjellës, t'iu ofrohet siguria 24 orëshe.

Pas shqyrtimit të ofertave nga ana e komisionit i përbërë nga DKA dhe SHML "Naim Frashëri", do të përzgjidhet oferta më e favorshme dhe me plotësim të kushteve sipas Ligjit. Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në DKA në ndërtesën e Komunës së Shtimes (Kati III).

Afati i paraqitjes me të gjitha dëshmitë dhe dokumentacionin është shtatë (7) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe web-faqe zyrtare të Komunës së Shtimes.

Ofertat do të hapen me të skaduar afati i ofertës, 7 ditë nga data e shpalljes, në DKA- Shtime ora 13:00. Ofertuesi i përzgjedhur nga komisioni i merr të gjitha obligimet sipas UA nr. 02/2016. Përzgjedhja e ofertuesit bëhet e ditur në ora 15:00.

Drejtori :
Ilir Haxhiu

Drejtori,
Rexhep HASANI